

VENDIM
Nr. 153, datë 2.3.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 5.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “BULEVARDI VERIOR DHE REHABILITIMI I LUMIT TË TIRANËS”, FAZA I, NË BASHKINË E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 752, datë 5.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Vlera e plotë e shpronësimit, prej 1 757 476 521 (një miliard e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e një) lekësh, do të përballohet në masën 550 000 000 (pesëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë dhe, pjesa e mbetur, nga Bashkia e Tiranës.”.

2. Pika 9 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“9. Ngarkohen Bashkia e Tiranës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama